



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2274 prot.

Tepelenë, më 14.07.2026

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tepelenë.

KËSHILLTARËVE TË BASHKISË

Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë.

Për dijeni: **KRYETARIT TË BASHKISË Z. GRAMOS SAKO**

Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë.

Të nderuar Këshilltarë,

Ju njoftoj se ditën e hënë më datë 20.07.2026, ora 11:00, në Pallatin e Kulturës Tepelenë (kati i dytë) do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, si dhe "Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak", me rend dite si vijon:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 26.06.2026.
3. **Projektvendim:** : "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Qershor 2026".
4. **Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Qershor 2026".
5. **Projektvendim:** "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 77 datë 22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026" i ndryshuar
6. **Projektvendim:** "Për miratim të kërkesës, për heqje dore nga pasuria e paluajtshme me status juridik "Në përdorim të Bashkisë Tepelenë" me numër pasurie 66/2, 291, 318 dhe 338 ZK2404 dhe numër rendor të pronës në listën e inventarit 485 sipas VKM nr. 386 datë 25.5.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kurvelesh të Qarkut të

Gjirokastrës” fusha e përdorimit Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)”

7. **Projektvendim:** “Për miratimin e modelit tip të strukturave të çmontueshme për njësitë tregtare ambulante në zonën turistike përgjatë aksit rrugor Tepelenë – Uji i Ftohtë –Hormovë
8. **Projektvendim:** “Për miratimin e masave administrative dhe nivelit të gjobave të aplikueshme në territorin e Bashkisë Tepelenë”.
9. **Projektvendim:** “Për miratimin e standardeve dhe vendosjen e sinjalistikës turistike për shtigjet, monumentet e kulturës dhe atraksionet turistike në territorin e Bashkisë Tepelenë”.
10. Çështje të tjera.
11. Trajtimi i kërkesa dhe ankesa të qytetarëve.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Arben GUMENI

